

13 qershor 2014, Prishtinë

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Trajtimi i ndërtimeve pa leje përbrenda zonave të mbrojtura

Ditë më parë Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka publikuar draftin e udhëzimit administrativ për Kërkesat Themelore të Shëndetit dhe Sigurisë për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, bazuar në ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, që është në fuqi që nga 5 shkurti i vitit 2014.

Në lidhje me ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje si dhe udhëzimin administrativ të sipër përmendur, shfrytëzojmë rastin të tërhiqim vëmendjen rreth disa aspekteve që kanë të bëjnë me trashëgiminë arkitekturale dhe zonat e mbrojtura. Sipas Neni 12, pika 2.7 e Ligjit, veç tjerash thuhet se: "Inspektimet e ndërtimit pa leje duhet të përcaktojnë që Aplikimet për Leje për legalizim do të refuzohen, pas inspektimit, nëse organi kompetent gjen se është i ndërtuar në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore".

Ligji për Trashëgiminë Kulturore dhe Ligji për Planifikim Hapësinor zonën e mbrojtur e përkufizon si "një hapësirë të vendit siç është përcaktuar në nenin 2 të Ligjit nr. 2003/14 për planifikim hapësinor, i cili është ambienti i perimetrit të trashëgimisë kulturore të paluajtshme që mund të mbrohet nga ndonjë zhvillim ose veprimtari që mund të dëmtojë kuadrin e dukshëm ose dëmtim tjetër të trashëgimisë kulturore" (Neni 2.21). Po ashtu, ligji përcakton se "monumentet arkitekturale nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme kanë një zonë të mbrojtjes, që është 50 metra nga perimetri i monumentit" (Neni 6.4).

Krahas udhëzimit administrativ drafti i të cilit është publikuar, e që ka të bëjë me Kërkesat Themelore të Shëndetit dhe Sigurisë për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje, e konsiderojmë mjaft të rëndësishme edhe rregullimin e çështjeve që ndërlidhen me ndërtimet pa leje në afërsi të ndërtesave të trashëgimisë kulturore (zonave të mbrojtura) përmes një udhëzimi administrativ ose përmes ndonjë rregulloreje tjetër. Është më se e rëndësishme që të sigurohet zbatimi me përpikmëri i ligjit sa i përket zonave të mbrojtura.

Për të evidentuar këto zona të mbrojtura, bazuar në Ligjin për Trashëgiminë dhe listën e trashëgimisë kulturore në mbrojtje të përkohëshme, EC Ma Ndryshe e punoi një hartë, në të cilën paraqiten të gjitha ndërtesat në qytetin e Prishtinës që janë në listën e trashëgimisë kulturore për mbrojtje të përkohëshme, si dhe perimetri prej 50 metrash që përbën zonat e mbrojtura rreth atyre ndërtimeve. Gjatë përgatitjes së dokumentacionit të trajtimit të ndërtimeve pa leje, u rekomandojmë komunave që në koordinim të plotë me MMPH-në dhe MKRS-në, të hartojnë harta të tilla apo të ngjashme zonale. Hartën zonale për qytetin e Prishtinës të përgatitur nga EC Ma Ndryshe, e gjeni në vegëzën www.online-transparency.org.

Ne besojmë që procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje është një rast shumë i mirë për trashëgiminë kulturore, i cili nëse shfrytëzohet në mënyrën e duhur mund ta shpëtojë atë nga ngufatja dhe degradimi i mëtejshëm. Për këtë arsye, ne kërkojmë nga MMPH, MKRS dhe komunat e Kosovës që të jenë të përpiktë në zbatimin e nenit 12 të ligjit për legalizime, i cili ndalon legalizimin e ndërtimeve pa leje në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgimisë kulturore.

Projekti i EC Ma Ndryshe për monitorimin e transparencës së Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe të Mbrojtjes së Mjedisit të komunës së Prishtinës do të vazhdojë të publikojë të gjeturat e monitorimit përmes komunikatave të rregullta dhe përmes ueb-faqes së projektit, ku të gjeturat postohen drejtpërdrejtë nga monitoruesit. Të gjitha të gjeturat e monitorimit, përfshi komunikatat e rregullta dhe shumë informacione të tjera në lidhje me qeverinë lokale të Prishtinës do të publikohen në ueb-faqen e projektit, www.online-transparency.org.

arch. Rozafa Basha, koordinatore projekti
OJQ EC Ma Ndryshe
Saraqët 5, 20000 Prizren
Perandori Dioklecian 14 (kati V), 10000 Prishtinë
www.ecmandryshe.org & info@ecmandryshe.org
+381 38 224 967 & +381 29 222 771
rozafa.basha@ecmandryshe.org



British Embassy
Pristina

Projekti "Transparenca Online e komunave të Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës" përkrahet financiarisht nga Ambasada e Mbretërisë së Bashkuar në Prishtinë.